

# TABLETI

Tableti është një kompjuter portativ personal i vogël. Tabletët janë më të vegjël se laptopët, por më të mëdhenj se telefonat mobil me një sistem operativ për celular dhe LCD ekran me prekje.

Ngjashëm me një kompjuter, ku lëviz miun për të naviguar në ekran, tek tabletët mund të përdorim gishtërinjtë ose stilolapsin për të bashkëvepruar me dritaret në ekran, për të hapur aplikacione, vizatime, për të luajtur lojëra etj. E njëjta gjë vlen edhe për tastierën, kur nevojitet të shkruhet diçka, një tastierë shfaqet në ekran ku mund të prekim tastet e nevojshme.

Tableti është një pajisje me përparësi të mëdha, duke filluar nga bartja me vete në teren, është shumë lehtë i përdorshëm dhe mund të ju ndihmojë në realizimin e projekteve në lëndë të ndryshme, duke ju mundësuar përdorim të aplikacioneve të ndryshme, si dhe për të hulumtuar tema përkatëse. Tableti mund të ketë lidhje direkte me TV pa kablo përmes opsionit 'Screen Mirroring', në mënyrë që studentët të kenë më të lehtë të shfaqin projektet, materialet, detyrat etj.




---

# Puna me Tablet


Për të qenë efikas në përdorimin e tabletit, duhet të njohet me terminologjinë e cila përdoret gjatë punës me menynë Android:

- Home screen - Pamja e cila shfaqet pasi të hapim tabletin
- Lock Screen - Pamja e cila shfaqet kur ekrani është i ndezur, por është i mbyllur
- App – Programet ose Aplikacionet janë versione mobile të programeve kompjuterike, faqeve të internetit dhe shërbimeve.
- App Draëer/Sirtari i aplikacioneve - Zona në të cilën të gjitha aplikacionet e tabletit tuaj janë ruajtur.



- Long-press/Klikimi i zgjatur - Veprim i cili përdoret për të lëvizur/ri-rendit aplikacionet ne ekranin e tabletit, ose të hapim menynë e veprimeve. Prekni dhe mbani të shtypur kudo në ekran për të aktivizuar klikimin e zgjatur
- Zona e njoftimeve - është zonë njoftimi që mund të tërhiqet nga maja e sipërme e ekranit. Në këtë zonë, zakonisht gjenden shkurtesat e konfigurimeve të përdorura shpesh, si Wi-Fi dhe Bluetooth.




- Settings/Konfigurimet – Është një aplikacion (ikona e tij është zakonisht në formë të një dhëmbëzori  ) që përmban të gjitha preferencat, opsionet dhe detajet e konfigurimit të tabletit tuaj. Nëse dëshironi të ndryshoni një aspekt të tabletit tuaj, përgjigjia është ndoshta në Settings.

## Butonat në tabletin tuaj

Përderisa pjesa kryesore e punës që bëni me tabletin tuaj do të ndodh në ekran, ka disa butona fizik që duhet të keni parasysh

- **Volumi** - Dy butonat në anën e majtë të tabletit kontrollojnë volumnin e zërit. Butoni i lartë zakonisht rrit volumnin, ndërsa butoni i poshtëm zakonisht ul volumnin.
- **Lock/Mbyll** - Ky buton zakonisht gjendet në anën e sipërme ose të djathtë të tabletit. Shtypja e saj do të fik ekranin dhe "mbyll" tabletin, që do të thotë që do të duhet të rrrëshqisni në ekranin kryesor (dhe futni një fjalëkalim nëse është konfiguruar) për ta rifilluar punën me tabletin tuaj.
- **Back/Kthehu një hap prapa** - Ky buton zakonisht gjendet në pjesën e poshtme të majtë ose pjesën e poshtme të djathtë të tabletit. Klikimi i këtij butoni do të ju kthej një hap prapa.
- **Home** - Ky buton zakonisht është në pjesën e mesme dhe të poshtme të tabletit. Ky buton do t'ju shfaq përsëri ekranin kryesor, duke ju lejuar të dilni nga aplikacionet dhe menutë tjera.



**Fikja e tabletit** - Shtypni dhe mbani butonin Lock në pjesën e sipërme ose në pjesën anësore të tabletit, pastaj prekni Power off në menynë pop-up që shfaqet. Sistemi operativ Android i tabletit do të fillojë procesin e fikjes.


Ndoshta do të duhet të prekni POWER OFF kur kërkohet për të konfirmuar këtë vendim.



**Ndezja e tabletit** -Shtypni dhe mbani butonin Lock për të filluar ndezjen e tabletit.

**Hapja e tabletit** - Rrëshqitni nga e majta në të djathtë në ekranin kryesor. Kjo do të hapë tabletin tuaj, duke ju lejuar të filloni ta përdorimin e tabletit.

## Lidhja e tabletit me internet Wi-fi


1. Rrëshqitni nga lartë poshtë duke filluar nga maja e ekranit. Duke bërë kështu hapim zonën e njoftimeve

2. **Shtypni dhe mbani Wi-Fi**  - Është zakonisht në anën e sipërme të majtë të menisë. Kjo do t'ju çojë te konfigurimet e Wi-Fi

3. Shtypni butonin nderprerës "Wi-Fi" , pas shtypjes do të duket kështu  . Kjo do ta aktivizoj Wi-Fi. Nëse ky buton është i gjelbër ose kaltër, atëherë Wi-Fi është i aktivizuar

4. Klikoni emrin e rrjetit tuaj. Gjeni emrin e rrjetit Wi-Fi me të cilin doni të lidheni
5. Futni fjalëkalimin e rrjetit nëse kërkohet. Nëse rrjeti nuk ka fjalëkalim, do të lidhet automatikisht pas klikimit të emrit të rrjetit.

## Shkarkimi i aplikacioneve

1. Hapni sirtarin e aplikacioneve. Është në pjesën e poshtme të ekranit kryesor.
2. Hapni aplikacionin me emrin Google Play Store app 
3. Pasi të hapet aplikacioni, shtypni shiritin e kërkimit i cili gjendet në krye të ekranit
4. Shkruani emrin e aplikacionit që dëshironi të shkarkoni p.sh “PocketLab”
5. Pasi të ju hapet lista e aplikacioneve të cilat ndërlidhen me kërkimin tuaj zgjedhni aplikacionin që doni të shkarkoni
6. Për të shkarkuar aplikacionin:
  - a. Nëse aplikacioni është pa pagesë, atëherë klikoni butonin e gjelbër “INSTALL”
  - b. Nëse aplikacioni është me pagesë, atëherë klikojmë butonin e gjelbër me çmimin e aplikacionit (p.sh \$ 2.49) dhe ndjekim instruksionet për të përfunduar pagesën e shkarkimit të aplikacionit.




## Pasqyrimi i ekranit nga tableti në TV përmes Wi-Fi

1. Lidhni televizorin dhe tabletin në të njëjtin rrjet Wi-Fi.
2. Në TV - Zgjedh "Screen Mirroring" apo "Pasqyrim i ekranit" si burim për TV.
  - Duke përdor telekomandën e televizorit, shtypni butonin "SOURCE" dhe "Screen Mirroring".



3. Në tablet - Hapni zonën e njoftimeve (duke rrëshqit poshtë nga maja e sipërme e ekranit dhe pastaj hapni zonën e njoftimeve) të zgjeruar ku shihen të gjitha konfigurimet e mundshme.
4. Në tablet - Shtypni "Screen Mirroring" ose "Smart View"
  - Varësisht nga modeli i tabletit, kjo mund të quhet "Smart View", "Screen Mirroring" ose "Cast"



5. Për të ndalur pasqyrimin e ekranit, në tablet shtypni ikonën e pasqyrimit pasaj shtypni “Stop Casting” ose “Disconnect”

## Pasqyrimi i ekranit nga tableti në TV përmes kabllos

Për të mundësuar pasqyrimin e ekranit të tabletit në TV na duhet një kablo HDMI dhe një kablo të përshtatshme e cili lidhet me portin MicroUSB i cili mundëson lidhjen e tabletit.

Për të realizuar këtë lidhje, i përcjellim hapat si më poshtë:

1. Sigurohuni që televizori juaj mbështet HDMI
  - a. Këtë mund ta verifikoni duke e kontrolluar TV për hapësirë fizike për ta kyçur HDMI kablлон.



---

## 2. Përdorni një konvertues MicroUSB-to-HDMI



3. Lidhni adapterin MicroUSB-to-HDMI me tabletin tuaj. Futni njërën anë të kabllos HDMI në pjesën e lidhur për tablet, dhe anën tjetër të HDMI kabllos lidheni me TV
4. Ndizni TV
5. Në TV - Shtypni butonin “Source” në telekomandë, dhe pasi të shfaqet lista e opsioneve zgjedhni “HDMI”. Pasi të zgjedhni këtë opsion, ekrani juaj i tabletit duhet të shfaqet në TV.